

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "Roman Restaurant" Sh.p.k.

Sot, me datë 16/05/2023,

- **"Instituti Profesional ATC" Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Sheshin "Karl Topia", Kompleksi 127, Kulla 3, Kati i dytë, Tiranë, me NUIS L221050230, përfaqësuar nga Administratori **Z. Altin Zefi**, shtetas shqiptar, lindur më 10/03/1986, në Pukë, mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. Personal I60310047T, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"(i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ka vendosur të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "Roman Restaurant" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1
EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "Roman Restaurant"Sh.p.k.

NENI 2
SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Zona kadastrale nr. 2297, Nr. Pasurie 1/229, Ksamil, Sarandë.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4
OBJEKTI


Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

- Bar, Restorant.

Shoqëria mund të kryejë gjithashtu të gjitha operacionet tregtare, mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, operacione financiare, industriale, që do të vlerësohen të nevojshme apo të dobishme për realizimin e objektit të shoqërisë si dhe të blejë pjesëmarrje në kapitalin themeltar të shoqërive të tjera që kanë objekt të njëjtë, të ngjashëm apo që lidhet me të vetin. Shoqëria në ushtrimin e aktivitetit të saj, do të marrë të gjitha autorizimet e lejet e nevojshme pranë institucioneve publike shqiptare, dhe do të mbështetet në rregullat dhe normat në fuqi në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë së saj të rregullt ekonomike.

NENI 5
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakut themelues në vlerën 1.000.000 Lekë (një milion) dhe është i përbërë nga një kuotë.



Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- **"Instituti Profesional ATC" Sh.p.k**, zotëron 1 kuotë, me 100% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 1.000.000 (një milion) Lekë dhe 1.000.000 (një milion) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori/ët. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. **Z. Altin Zefi**, shtetas shqiptar, lindur më 10/03/1986, në Rrape, Pukë, banues në Tiranë, mbajtës i dokumentit Kartë Identiteti me nr. Personal I60310047T, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administrator për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortaku themelues i shoqërisë, duke autorizuar **Administratorin Z. Altin Zefi** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES
"Instituti Profesional ATC" Sh.p.k
Përfaqësuar nga
Altin Zefi

